



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.120**

**14 shtator**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.567, datë 5.9.2007	Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave, për caktimin e pronave, fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik .....	3399
Vendim i KM nr.568, datë 5.9.2007	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parashkollor, kopsht “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.....	3400
Vendim i KM nr.569, datë 5.9.2007	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.....	3401
Vendim i KM nr.571, datë 5.9.2007	Për miratimin e statutit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.....	3401
Vendim i KM nr.577, datë 5.9.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”	3405
Vendim i KM nr.579, datë 5.9.2007	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.....	3406
Vendim i ERE nr.54, datë 7.9.2007	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit për licencimin e shoqërisë “CERS” sh.p.k. për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre.....	3406
	Ndreqje gabimi.....	3407

**VENDIM**  
**Nr.567, datë 5.9.2007**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE, PËR CAKTIMIN E PRONAVE, FOND PASURIE TË PALUAJTSHME, PËR KOMPENSIM FIZIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Fondi për kompensimin fizik përbëhet nga pasuri të paluajtshme, pronë shtetërore, sipas inventarit të Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronës Publike (AITPP), për të cilat nuk ka asnjë akt shpronësimi, shtetëzimi, konfiskimi apo marrjeje në mënyrë të padrejtë nga shteti, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Pasuri të paluajtshme publike, me vendndodhje në zonat, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, me përjashtim të sipërfaqeve të përcaktuara në shtojcën nr.1 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar;

b) Prona, në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës;

c) Tokat bujqësore, disponibël, shtetërore të ish-ndërmarrjeve bujqësore. Tokat bujqësore, që disponohen nga ish-institucionet kërkimore-shkencore të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (aktualisht QTTB-të, ISUV-ja dhe Stacioni i Duhanit, Cërrik) mbeten në administrim të tyre, për nevoja të veprimtarisë funksionale, në sipërfaqe të përcaktuara nga ministri. Sipërfaqja tjetër, mbi këto nevoja, shërben si fond për kompensimin fizik;

ç) Pyje, kullota dhe livadhe;

d) Prona të përfshira në çdo veprimtari të institucioneve shtetërore, qendrore apo vendore, që janë jashtë destinacionit të veprimtarisë së tyre;

dh) Prona të dhëna me qira, të cilave u është ndryshuar destinacioni i objekteve të ndërtuara dhe investimi i kryer nuk i kalon 150 për qind të vlerës së tokës;

e) Sipërfaqe të mbetura të lira pas legalizimeve dhe të konfirmuara të tilla nga ALUIZNI.

2. Në bazë të regjistrit të krijuar nga grumbullimi i të dhënave nga të gjitha institucionet, që administrojnë pasuritë e mësipërme, si dhe në bazë të të dhënave të Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronës Publike, krijohen hartat e pronave përkatëse, sipas vendndodhjes, në qarqe. Në këtë hartë saktësohen kufijtë dhe sipërfaqet e secilës pronë.

3. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, që administrojnë pronat shtetërore, të evidentojnë pronat e përmendura në pikën 1, të cilat do të jenë pjesë e fondit për kompensimin fizik. Për çdo pasuri, institucionet përkatëse përgatisin dosjen e dokumentacionit të pronës dhe e përcjellin në AKKP (zyrën qendrore apo zyrat rajonale, sipas vendndodhjes së pronës).

4. Institucionet e përcaktuara më sipër paraqesin në AKKP (zyrën qendrore apo zyrat rajonale):

a) listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në administrim apo pronësi të tyre;

b) dosjen e pronës përkatëse, e cila, sipas rastit, përmban:

i) dokumentacionin e objekteve, sipas përcaktimeve të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 11.10.2006 “Për kriteret e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo objekteve të veçuara, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare” dhe nr.704, datë 11.10.2006 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe procedurën e shitjes”;

ii) dokumentacionin e tokës bujqësore, shoqëruar me hartën treguese të kufijve të saj;

iii) dokumentacionin e pyjeve, të kullotave dhe livadheve, shoqëruar me hartën treguese të kufijve të tyre;

iv) dokumentacionin e tokës, me vendndodhje brenda zonës me përparësi zhvillimin e turizmit, shoqëruar me hartën treguese të kufijve dhe studimin e miratuar të zhvillimit urbanistik të zonës;

c) dokumentin e pronësisë, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

5. AKKP-ja (zyra qendrore apo zyrat rajonale) kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) Shqyrton dokumentacionin e dosjes së pronës, të paraqitur nga institucionet, dhe verifikon nëse:

i) pronësia mbi këto pasuri u është njohur, kthyer apo kompensuar më parë subjekteve të shpronësuara;

ii) ka në shqyrtim kërkesa/ankesa për njohje të pronësisë për pronat, të cilat bëjnë pjesë në listën e pasurive, që do të shërbejnë si fond për kompensim fizik.

b) hedh në hartë pronat e paraqitura.

6. Në rast se për prona, brenda fondit për kompensim fizik, evidentohen pretendime nga subjektet e shpronësuara, atëherë deri në nxjerrjen e vendimit për këto pretendime, pasuria në fjalë do të përjashtohet nga lista e fondit të pasurive të paluajtshme, që do të shërbejnë për kompensim fizik.

7. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas vendndodhjes së pronës, të verifikojnë dhe konfirmojnë gjendjen juridike të çdo prone shtetërore, të paraqitur nga institucionet shtetërore përkatëse, që do të bëjë pjesë në fondin për kompensim fizik.

8. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së i paraqet Ministrit të Drejtësisë listën përfundimtare të të gjitha pasurive të paluajtshme, që do të bëjnë pjesë në fondin për kompensimin fizik, të grupuara sipas qarqeve, të shoqëruar me të dhënat kryesore të pronës si: lloji i pasurisë, vendndodhja, zona kadastrale, numri i pasurisë përkatëse, sipërfaqja në m<sup>2</sup>, kufizimet, si dhe vlera përkatëse e secilës prej tyre.

9. Lista e pasurive të paluajtshme, që do të shërbejë për kompensim fizik, e miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe e shoqëruar me përshkrimin e pronës, botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.568, datë 5.9.2007**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARASHKOLLOR, KOPSHT “TIRANA INTERNATIONAL SCHOOL”, QË DO TA  
ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, të arsimit parashkollor, kopsht “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.569, datë 5.9.2007**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE “TIRANA INTERNATIONAL SCHOOL”,  
QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.571, datë 5.9.2007**

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e statutit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.84, datë 18.2.2005 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Entit të Turizmit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

# STATUTI I AGJENCISË KOMBËTARE TË TURIZMIT

## KREU I

### Neni 1

#### **Statusi juridik dhe baza ligjore**

1. Agjencia Kombëtare e Turizmit ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës, të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Agjencia Kombëtare e Turizmit, më tej “AKT”, është ent publik me statusin e personit juridik publik në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin”.

### Neni 2

#### **Selia, vula dhe stema**

AKT-ja ka selinë në Tiranë. AKT-ja ka vulën e vet në formë rrethore ku përcaktohet emërtesa ligjore e institucionit: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Agjencia Kombëtare e Turizmit“.

## KREU II

### MISIONI, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E AKT-SË

### Neni 3

#### **Misioni i AKT-së**

Misioni i AKT-së është:

1. Zbatimi i politikave shtetërore dhe kombëtare në fushën e turizmit, promovimi dhe krijimi i identitetit të turizmit shqiptar, nëpërmjet shfrytëzimit të gjithë potencialit ekzistues turistik të vendit.

2. Zbatimi i detyrimeve që burojnë nga strategjia kombëtare e turizmit dhe linja e veprimit, si dhe planet vjetore të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Përgatitja e programeve për sigurimin e asistencës financiare për projektet që kanë për qëllim përmirësimin e sektorit të turizmit në vend.

### Neni 4

#### **Detyrat dhe kompetencat e AKT-së**

1. AKT-ja ideon dhe realizon marketingun e turizmit shqiptar, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, bashkërendon dhe mbështet veprimtaritë rajonale të marketingut, organizon dhe përfaqëson vendin në panaire dhe ekspozita turistike kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me rregullat ligjore në fuqi.

2. Harton dhe realizon botimet me karakter promociional në përputhje me standardet, kërkesat dhe tendencat e tregut turistik ndërkombëtar, rajonal dhe të brendshëm.

3. Monitoron, përmirëson dhe përditëson faqen zyrtare të promociionit të turizmit shqiptar.

4. Harton dhe përditëson të dhënat mbi potencialin turistik të vendit, me qëllim promovimin e tij.

5. AKT-ja ka të drejtë t'i propozojë ministrit përgjegjës për turizmin, përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, që veprojnë në fushën e turizmit, duke argumentuar arsyet që lidhen me këto propozime.

6. AKT-ja i paraqet ministrit përgjegjës për turizmin programet e asistencës financiare të hartuara në përputhje me:

a) fondin vjetor, të miratuar, të zhvillimit të turizmit dhe sipas mënyrës së përdorimit të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, sipas dispozitave në fuqi për ndihmën shtetërore dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

c) Programet e asistencës financiare, të cilat jepen në bazë të formularëve të aplikimit dhe manualit të miratuar për këtë qëllim nga AKT-ja, si dhe sipas llojit të asistencës financiare në përputhje me pikën 3 të nenit 26 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

7. AKT-ja harton programe të asistencës financiare të cilat duhet të përmbajnë:

a) masën, në përqindje, të fondit të investimit që do të mbështetet nga AKT-ja nëpërmjet fondit të zhvillimit të turizmit;

b) kohëzgjatjen e përfitimit të asistencës financiare;

c) mënyrën e livrimit të saj për aplikantët që duhet të përfitojnë asistencë financiare;

d) numrin e qëndrueshëm të të punësuarve për një periudhë vazhdimësie, prej jo më pak se 5 vjet;

e) rezultatin e pritshëm: ekonomik/social/mjedisor/kulturor të projektit turistik që kërkohet të mbështetet nga programet e asistencës financiare.

8. AKT-ja administron fondin e zhvillimit të turizmit, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e përdorimit të fondit të zhvillimit të turizmit”.

9. Kontrollon nëpërmjet strukturave të saj përgjegjëse, të autorizuara nga ministri përgjegjës për turizmin, çdo subjekt që ka përfituar asistencë financiare, sipas ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” dhe i propozon ministrit ndërprerjen e saj, kur vëren mosrespektim të kushteve për të cilat është përfituar kjo asistencë.

10. Monitoron zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese të qirave dhe zhvillimit, ushtron kontroll dhe verifikon përputhjen e strukturave turistike të ndërtuara me marrëveshjet e lidhura, si dhe i relatton ato pranë ministrit përgjegjës për turizmin.

11. AKT-ja lehtëson shërbimet për biznesin privat të turizmit, për individët dhe subjektet juridike në zonat e zhvillimit turistik, fshatrat turistike, vendet dhe pikat turistike që veprojnë në sipërmarrje turistike (nëpërmjet tarifave të përcaktuara).

12. AKT-ja, përveç subjekteve të tjera të përcaktuara në ligj, ka të drejtë t'i propozojë ministrit përgjegjës për turizmin, njohjen e fshatit turistik në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” dhe rregulloren e miratuar nga ministri, për standardet, kriteret dhe procedurat për përcaktimin dhe njohjen e fshatit turistik.

13. AKT-ja administron të ardhurat që realizon nga shërbimet e ofruara ndaj biznesit turistik dhe që përftohen nga grandet/donacionet apo burime të tjera të ligjshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

## Neni 5

### **Bashkëpunimi institucional**

1. AKT-ja bashkëpunon dhe bashkërendon punën me organet shtetërore, qendrore e vendore, për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, si dhe zbatimin e masave që lidhen me mbarëvajtjen e sezoneve turistike.

2. AKT-ja nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për turizmin, bashkëpunon me organizata ndërkombëtare, në projekte të huaja apo të përbashkëta, në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të turizmit në vend.

3. AKT-ja bashkëpunon me institucionet kërkimore dhe shkencore që lidhen me fushën e turizmit, me qëllim sigurimin e të dhënave mbi potencialet turistike, natyrore dhe kulturore të vendit.

4. AKT-ja bashkëpunon me personat fizikë/juridikë privatë, veprimtaria e të cilëve synon studimin e tregut dhe promovimin në nivel vendor, lokal e rajonal.

## KREU III ORGANIZIMI I AKT-SË

### Neni 6 **Struktura dhe organika**

1. Struktura dhe organika e AKT-së përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Titullari i AKT-së është drejtori, i cili, drejton veprimtarinë e AKT-së, në përputhje me këtë statut dhe me ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

3. Kandidati për t’u emëruar në detyrën e drejtorit të AKT-së nuk duhet të këtë konflikt interesi në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

4. Marrëdhëniet juridike të punës, të drejtat dhe detyrimet, si dhe procedurat e rekrutimit të nëpunësve të AKT-së mbështeten në dispozitat e Kodit të Punës.

5. Niveli i pagave të punonjësve të AKT-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 7 **Mënyra e organizimit**

AKT-ja për përmbushjen e veprimtarisë, sipas ligjit dhe këtij statuti, organizohet sipas kësaj strukture:

- Drejtori i AKT-së;
- Drejtorja e Asistencës;
- Drejtorja e Marketing-Promocionit;
- Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse.

### Neni 8 **Detyrat e drejtorit të AKT-së**

1. Drejtori i AKT-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri përgjegjës për turizmin, në përputhje me vendimin nr.173, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra e drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

2. Drejtori i AKT-së ka këto të drejta dhe detyra:

a) Drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e AKT-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për turizmin;

b) Harton rregulloren e brendshme të funksionimit të AKT-së dhe e paraqet për miratim te ministri përgjegjës për turizmin. Në rregulloren e brendshme përcaktohen rregullat e funksionimit të sektorëve, detyrat dhe përshkrimet e pozicioneve të punës për çdo specialist etj, nëpërmjet të cilave ushtrohet aktiviteti i përditshëm i AKT-së;

c) Bashkërendon punën për hartimin e projektbuxhetit, sipas rregullave dhe afateve, që përcakton ligji organik për Buxhetin e Shtetit, dhe ia paraqet për miratim ministrit që mbulon fushën e turizmit;

ç) Propozon programin vjetor të veprimtarive të AKT-së dhe e paraqet për miratim te ministri përgjegjës për turizmin;

d) Përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;

dh) Nxjerr urdhra dhe udhëzues në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara në këtë statut;

e) Përcakton kriteret e marrjes në punë të personelit të AKT-së dhe përshkrimin e vendeve të punës;

g) Emëron, liron dhe shkarkon nga detyra nëpunësit e AKT-së, në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin për Kodin e Punës.

KREU IV  
ORGANIZIMI FINANCIAR

Neni 9  
**Buxheti i AKT-së**

1. AKT-ja është institucion buxhetor.
2. Administrimi dhe veprimtaria financiare auditohet nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe institucionet e tjera të ngarkuara me ligj, për auditim.

Neni 10  
**Dispozita të fundit**

Ndryshimet në këtë statut bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**VENDIM**  
**Nr.577, datë 5.9.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.463, DATË 5.7.2006 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR  
ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull, pas fjalëve “...Stabilizim-Asociimit” të shtohen “...2007-2012”.
2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“1. Miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2007-2012, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.
3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, të raportojnë pranë Ministrisë së Integritit, në fillim të çdo muaji, për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sipas metodologjisë së hartuar nga kjo Ministri. Grupi ndërministror i punës për shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e punës, për zbatimin e angazhimeve të marra, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, vlerëson dhe analizon, periodikisht, zbatimin e këtij plani.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.579, datë 5.9.2007**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME “TIRANA  
INTERNATIONAL SCHOOL”, QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN  
ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.54, datë 7.9.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“CERS” SHPK PËR AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT  
TË CENTRALEVE ELEKTRIKE, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
ANA E TYRE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18, pika 1, germa “a”, dhe neni 19, pika 1 dhe 2, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullorja e procedurave të licencimit” neni 10, pika 1, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 7.9.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “CERS” sh.p.k. për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë “CERS” sh.p.k. për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me ERE, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre, për perqet eolike Lezhë, Kavajë, Hamallaj, Panaja dhe Karaburun.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

## **NDREQJE GABIMI**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.554, datë 15.8.2007 “ Për disa ndryshime në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin “Dëshmor i Atdheut”, të ndryshuar” të botuar në Fletoren Zyrtare nr.117, 10 shtator 2007 bëhet korigjimi si vijon:

është nr.554, bëhet nr.544.

Domethënë, korigjohet numri i vendimit të Këshillit të Ministrave.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

## BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

### *Së shpejti në treg:*

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 13.9.2007  
Doli nga shtypi më 14.9.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë